



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 11.10.2016

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “PËRSHTATJA E GODINËS  
SË DREJTORISË SË KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME TIRANË NË  
GODINË TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË APELIT TIRANË, BASHKIA TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Përshtatja e godinës së Drejtorisë së Konvikteve të Shkollave të Mesme Tiranë në godinë të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit zhvillues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë;
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOFA**

**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

